



Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Bashkangjituni!

Takimi i Rregullt i RrGGK

2 Shtator, 10:45 – 13:00, Hotel Prishtina

Të gjeturat fillestare: “Ku janë paratë për të drejtat e grave?”

2 Shtator, 14-16, Hotel Prishtina

Retreat i RrGGK (Vetëm anëtarët)

3-6 Tetor, Durrës, Shqipëri

Në këtë numër

Retreati e Energjizon Stafin e RrGGK

dhe e Motivon për Punë të

Mëtutjeshme2

Shoqata e Re Fuqizon Gratë e Shurdhëra

në Prizren.....2

OJQ “Prehja” Inkurajon Konrollet për

Parandalimin e Kancerit3

“Piazza” e Re Ngritë Vetëdijen për të

Drejtat e Grave.....3

Kori i Grave “Lira” Këndon në një

Festival Ndërkombëtarë4



Faqja në Facebook



Lista për dërgesat e E-Lajmeve

Meshkujt i Bashkangjiten RrGGK si Anëtar Individual

Javën e kaluar RrGGK filloi Programin e vet të ri të Anëtarimit Individual. Ne gëzohemi që tre meshkuj tashmë iu bashkangjitën RrGGK-së si anëtar individual! Dëshëm të shfrytëzojmë pak kohë për të shprehur mirënjohjen për secilin nga këta tre individualisht, të cilët kanë qenë përkrahës të mëdhenj të punës së RrGGK edhe në të kaluarën!

I pari që iu bashkangjiti RrGGK-së, është Arber Sylejmani, i cili ka zhvilluar uebfaqen tonë, përfshirë edhe krijimin virtual të formularit tonë të ri për anëtarim. Ai është gjithmonë përreth, duke u përgjigjur shpejtë në nevojat tona dhe duke mbështetur punën tonë.

I dyti, Hajrullahu Çeku ka bashkëpunuar ngushtë me RrGGK-në në një numër aksionesh, duke filluar nga performancat në rrugë tek protestat tek petitionet. Ne e ndjejmë solidaritetin e tij si aktivist në shumë aktivitete tona.

I treti është Krenar Basha nga shtypshkronja Night Design i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e publikimeve të RrGGK-së për marrëdhënie me publikun. Ai poashtu është gjithmonë në dispozicion, duke na ndihmuar për çkado që kemi nevojë, shpesh nën kufizime të rënda kohore. Duke qenë një aktivist në zemër, ai promovon një numër çështjesh përmes talentit të tij si dizajner dhe publikues. Kjo përfshinë edhe printimin në letër të reciklueshme me ngjyrë të reciklueshme dhe ofrimin e zbritjeve në çmim për organizatat e grave.

Ne mirëpresim gra e burra të tjerë që t'i bashkangjiten RrGGK-së si anëtar individual. Si një admirues, mik apo përkrahës i RrGGK-së, tashmë nuk iu duhet të keni organizatën tuaj për tu anëtaruar. Ju duhet vetëm të ndjeni dëshirën për tu bërë pjesë e punës tonë. Ju lutem, na u bashkangjitni duke na shkruar në info@womensnetwork.org ose duke plotësuar aplikacionin në uebfaqen tonë.

„Anëtarët e RrGGK-së, mund të ndihen krenarë që janë pjesë e një rrjeti mbarë botëror të njerëzve të përkushtuar për të mbështetur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë.

Menaxhimi Financiar Transparent: Vënia në Praktikë

Me disa përjashtime, organizatat jo qeveritare (OJQ) në Kosovë kanë tendencën që të mos jenë shumë transparente me mënyrën se si i menxhojnë financat e tyre. Kjo është problematike për disa arsye. Nën një, OJQtë punojnë në të mirë të qytetarëve. Pasi që në shërbejmë publikun, ne kemi përgjegjësi që të jemi transparent në atë që bëjmë, se si ne marrim fonde dhe si i harxhojmë ato. Nën dy, burimet tona financiare shpesh në mënyrë origjinale vijnë prej taksa paguesve (në Kosovë ose jashtë vendit), apo prej individëve të cilët japin para për të na mbështetur. Ne kemi përgjegjësi të raportojmë se si paratë e tyre janë shpenzuar dhe cka është arritur me paratë e tyre. Përndryshe, ata mund të mos jenë të gatshëm të financojnë punën tonë përsëri. Nën tre, për organizatat që synojnë të mbajnë qeverinë të përgjegjshme, duhet të kenë sëpari shtëpitë e tyre në rregull. Nën katër, hulumtimi ynë i fundit “Ku janë paratë për të Drejtat e Grave?” tregon që disa donator në Kosovë hezitojnë të financojnë OJQ-të sepse organizatat nuk kanë paraqitur qartë ku kanë shkruar paratë në të kaluarën dhe qka kanë arritur ata me këto para. Kjo nuk do të thotë që organizatat nuk kanë arritur rezultate të rëndësishme, por ndoshta organizatat mund të bëjnë punë më të mirë duke treguar se sa para janë hartuar dhe qfarë rezultate janë arritur. Financimi i OJQ-ve në të ardhmen varet nga ajo se sa ata janë transparent me financat e tyre. ... **Vazhdon në fq. 4.**

Retreat Energjizon Stafin e RrGGK dhe e Motivon për Punë të Mëtutjeshme

Puna e kombinuar me argëtimin ishin formula e një retreati gjallërues dhe produktiv të stafit të RrGGK, të mbajtur me 1-2 Gusht në malet e bukura të Prevallës. Testi i profileve të personalitetit ishte ndoshta edhe aktiviteti më i paharrueshëm. Gjatë këtij ushtrimi, të gjitha iu nënshtruan një testi të shpejtë, argëtues për të përcaktuar nëse janë tipa krijues, romantik, luftëtarë dhe/ose ekspertë. Pastaj anëtarët e ekipit diskutuan gjatë personalitetet e tyre dhe të të tjerave, duke u munduar të gjenin mënyra për të përmirësuar ndërveprimet në mes të kolegeve, duke pasur parasysh personalitetin unik të secilës.

“Ky ushtrim ishte shumë i dobishëm për mua,” tha njëra nga anëtarët e stafit të RrGGK. “Tani i kuptoj edhe më mirë personalitetet e kolegeve të mia dhe do të dijë më mirë se si të veprojë në situata të ndryshme në punë.”

Koha e lirë, lojërat dhe vaktet e përbashkëta të ushqimeve poashtu ofruan hapësira të hapura për diskutime kuptimplota në mes të kolegeve. Shumë [foto](#) shënuan udhëtimin e tyre.

Në ditën e dytë, anëtarët e stafit diskutuan Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet e RrGGK-së gjatë një sesioni të analizës “FDMK” (e njohur ndryshe si SWOT analiza). Ide të ndryshme u ngritën gjatë këtij sesioni të shkëmbimit të ideve. Diskutimi nuk u fokusua vetëm në nevojat e stafit të RrGGK-së, por edhe në atë se çfarë iniciativa mund të kontribuojnë në fuqizimin e rrjetit dhe në organizimin e grave më gjërësisht.

“Për çdo gjë që reflektojmë dhe shkruajmë, gjithmonë duhet të mbajmë në mend edhe nevojat dhe sfidat e organizatave tona anëtare pasi që ne jemi këtu për t’i shërbyer anëtareve tona,” tha Nicole Farnsworth, Menaxhere e Programit në RrGGK.

Gjatë këtij sesioni, anëtarët e stafit vërejtën që përderisa RrGGK ka një deklaratë të misionit, rrjeti ende nuk e ka një deklaratë të shkruar të vizionit të tij. Anëtarët e stafit bashkëpunuan për të shkruar një draft të deklaratës së visionit e cila do t’i propozohet anëtareve të RrGGK-së për aprovim. Poashtu, edhe çështjet e tjera të identifikuar gjatë retreatit do t’iu ofrohen anëtareve të RrGGK-së në takimin e rregullt të radhës.

Anëtarët e stafit të RrGGK-së u pajtuan që retreati/trajnimi ishte relaksues, plot energji dhe shumë produktiv në identifikimin e hapave kyç për të vashduar më tutje. Në rrugën e kthimit për në Prishtinë, stafi i RrGGK ndjeu që e njohin më shumë njëra-tjetren dhe ishin të mbushura energji për veprime të ardhshme të përbashkëta, si kolege dhe mikeshat.



Të mbushura plot energji dhe motivim, stafi i RrGGK niset për në Prishtinë pas retreatit dy ditorë në Prevallë.

Shoqata e Re Fuqizon Gratë e Shurdhëra në Prizren

Krenare Ajdini filloi aktivitetin e saj si aktiviste e të drejtave të grave kur ishte duke punuar si interpretuese e gjuhës së shenjave nëpër takimet e RrGGK-së. Ajo filloi të punonte si interpretuese e gjuhës së shenjave për Shoqatën e Përonave të Shurdhër në Prizren (ShPSH) në Prizren vetëm nga dëshira e mirë për t’i ndihmuar të shurdhërit brenda komunës së tyre. Ajo për herë të parë morri pjesë në një takim të RrGGK-së në vitin 2012 si interpretuese e ShPSH-së.

“Gjatë këtij takimi unë mësova shumë gjëra të reja për OJQ-të dhe punën e tyre,” tha ajo. “Kur pashë mundësitë që rrjeti iu ofron grave, vendosa që të hap një OJQ të re për të shurdhër, vetëm për gra. Në këtë mënyrë doja që t’iu ofroja atyre më shumë hapësirë për të punuar, pasi që kjo hapësirë nuk iu ishte ofruar në OJQ-në tjetër deri më tani.” shtoi Krenarja.

Në Korrik të vitit 2013 Krenarja formoi Shoqatën e Grave të Shurdhëra në Prizren, një OJQ që synon fuqizimin e grave të shurdhëra. Ajo është në dijeni për çështjet me të cilat ballafaqohen gratë e shurdhëra, duke filluar me mungesën e interpretuesve të gjuhës së shenjave gjë që pastaj i shëndërron

gjërat e thjeshta në probleme. Për shembull, nëse një grua do të donte të bënte një kontrollë mjekësore, mungesa e interpretuesit e bën këtë gjë shumë të vështirë për t’i spjeguar gjendjen mjekut, si dhe për t’i kuptuar shpjegimet e mjekut. Për këtë arsye, Shoqata e Grave të Shurdhëra dëshiron të ndihmojë ato të zgjidhin këto çështje. Krenarja e pranon që krijimi i një organizate të re është një detyrë aspak e lehtë: krijimi i statutit, krijimi i bordit dhe çështje të tjera administrative. Megjithatë “stafi i RrGGK-së ishte gjithmonë aty për të më ndihmuar me dokumente, procedura dhe çdo çështje tjetër,” tha ajo. “Deri më tani unë jam shumë e kënaqur me interesimin dhe bashkëpunimin e shprehur nga anëtarët e OJQ-së tonë,” tha Krenarja. “Së bashku ne po punojmë për të gjetur mënyra për të financuar idetë tona. Në këtë mënyrë ne do jemi në gjendje të fuqizojmë gratë e shurdhëra në komunën tonë.”



Krenare Ajdini interpreton në gjuhën e shenjave në Takimin e Rregullt të RrGGK në vitin 2012.



Logoja e Shoqatës së Grave të Shurdhëra në Prizren simbolizon gjuhën e shenjave në Kosovë.

OJQ "Prehja" Inkurajon Kontrollet për Parandalimin e Kancerit

Kontrollet e rregullta mjekësore janë vendimtare për identifikimin e hershëm të shenjave të kancerit dhe trajtimit të tij me kohë. Kjo ishte një ndër pikat e theksuara nga Dr. Mejreme Maloku-Krasniqi, onkologe në Qendren Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) gjatë lighëratave që ajo mbajti në katër fshatra të Skënderajit.

Qendra e Gruas "Prehja" organizoi ligjëratat për të ngritur vetëdijen për kancerin e gjirit dhe i mbajti ato në katër fshatra të Skënderajit, ku morrën pjesë rreth 200 gra.

"Është më se e rëndësishme që të bëni kontrolle të rregullta," tha Dr. Maloku-Krasniqi. "Vetëm në këtë mënyrë ne mund të ndërmarrim hapa parandalues dhe të luftojmë kancerin e gjirit."

Dr. Maloku-Krasniqi inspiroi 30 gra të Komunës së Skënderajit që të shkojnë dhe të kryejnë kontrolle mjekësore në Institutin e Onkologjisë të QKUK-së. Gratë që morrën pjesë në ligjëratat mund të kryejnë kontrollet në të njëjten ditë, e OJQ "Mundësia" nga Mitrovica po ofron transportin për këto gra nga fshatrat e tyre për në Prishtinë.

"Njëra nga objektivat kryesore të projektit tonë ishte të ngrisim vetëdijen tek gratë për parandalimin e kancerit të gjirit," tha Jeton Rushit, Koordinator i Projektit në OJQ Prehja. "Duke e ditur faktin që vetëm vitin e kaluar për shkak të kancerit të gjirit ndërruan jetë 6 gra në komunën tonë, të cilat nuk kishin kushte të mira ekonomike për të kryer kontrollet mjekësore, ne mendojmë se iniciativa të tilla luajnë rol kyç në vetëdijësimin e grave për kancerin e gjirit, si dhe në ofrimin e kontrollave mjekësore pa pagesë."

Kjo iniciativë e përbashkët ka pranuar përkrahje nga Fondi i Grave të Kosovës i RrGGK-së në muajin Prill të vitit 2013.

Në të kaluarën, Qendra e Gruas "Prehja" ka ndihmuar gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit përmes organizimit të diskutimeve vet-ndihmuese, ku gratë mund të flisnin me psikologë dhe të pranonin këshilla se si ta përballojnë kancerin emocionalisht.



Gratë e Komunës së Skënderajit marrin pjesë në ligjëratat për kancerin e gjirit të organizuara nga OJQ Prehja.

"Piazza" e Re Ngritë Vetëdijen për të Drejtat e Grave

"Piazza e Grave" (Tregu i Grave) në sheshin Nëna Terezë në Prishtinë në mënyrë inovative shet produktet e grave, përderisa në të njëjten kohë organizon aktivitete në rrugë për të ngritur vetëdijen për të drejtat e grave.

"Piazza e Grave", i organizuar nga OJQ Rikotta, shet çdo ditë produkte ushqimore në këtë shesh shumë të frekuentuar nga këmbësorët. Përveç ndihmesës së grave anëtare të OJQ-së për të fituar të ardhura shtesë, ato planifikojnë të përdorin këtë hapësirë publike për të organizuar fushata në rrugë në tema që përfshijnë të drejtën e grave për edukim; pjesëmarrjen e tyre në vendim-marrje; kancerin e gjirit; dhe njerëzit që vuajnë nga dhuna në familje dhe trafikimi.

OJQ Rikotta ka hapur "Piazza-n" javën e kaluar sespe ato ishin të shqetësuar për mungesën e iniciativave të qytetarëve për të përkrahur të drejtat e grave dhe për pjesëmarrje në jetën publike.

"Iniciativat e qytetarëve janë vegla shumë të mira për promovimin e solidaritetit në mes të organizatave të grave, si dhe barazinë gjinore," tha Pranvera Bullaku, Drejtoreshë Ekzekutive e Rikotta-s. Ajo shpreson që "Piazza" do të ngrisë vetëdijen e kalimtarëve për çështjet me të cilat përballen gratë në jetën e përditshme.

"Piazza e Grave" është një iniciativë e ndërmarrë në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, e cila e ofroi hapësirën. Agim Gashi, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, hapi zyrtarisht "Piazzen e Grave" më 12 Gusht 2013.

"Ne mundohemi të mbështesim të gjitha iniciativat pozitive të qytetarëve të Prishtinës, veçanërisht ato që fokusohen në përkrahjen e të drejtave të grave dhe në punën e pandalur të tyre," tha Agim Gashi, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Publike.

Kjo iniciativë përkrahet nga Fondi i Grave të Kosovës të RrGGK, prej të cilit Rikotta ka pranuar €2,990 gjatë muajit Korrik 2013.

Ju mund të ndaleni aty çdo ditë dhe të mësoni më shumë për këtë iniciativë dhe/ose të bleni ndonjë produkt të gatuar nga gratë: Piazza gjendet në sheshin Nëna Terezë në Prishtinë, pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



Agim Gashi, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, prenë tortën e gatuar nga anëtarët e OJQ Rikotta dhe shënon në këtë mënyrë hapjen zyrtare të "Piazzas së Grave".

Kori i Grave “Lira” Këndon në një Festival Ndërkombëtarë

Për herë të parë, 16 anëtare të Korit të Grave “Lira” morrën pjesë në Festivalin Ndërkombëtarë të Korit, i cili u mbajt në Nikoileka, Greqi, me 3-5 Gusht. Programi i tyre përfshinte dhjetë këngë, përfshirë edhe këngë që fillimisht kanë qenë këngë popullore, të adaptuara për korin e grave nga kompozitori Tomor Berisha. Festivali, i mbajtur për të dhjetën herë me radhë që nga viti 2003 mirëpreiti koret nga vende të ndryshme, përfshirë ndër të tjerë edhe Lituaninë, Italinë, Turqinë, Bosnie & Hercegovinën, Greqinë, etj.

“Përfaqësimi i Kosovës jashtë vendit është shumë i rëndësishëm,” tha Valire Spahija-Buza e cila udhëheqë korin Lira. “Na jep mundësinë të krijojmë miqësi, të identifikojmë mundësi bashkëpunimi dhe të kemi mundësinë e jashtëzakonshme për të njohur popuj dhe kultura të tjera,” tha ajo.

Praktikimi i Menaxhimit Financiar Transparent (Vazhdon prej fq. 1)

...se sa mirë i paraqesin rezultatet e tyre tek donatori dhe komuniteti (si mbështetës potencial në të ardhmen).

Ndoshta mendoni “Një moment, ju lutem. Unë jam transparent. Unë nuk jam njëra prej këtyre organizatave”. Në rregull, këtu janë disa pyetje mjaft të rëndësishme për ju:

- A përgatitni ndonjë raport vjetor me informatat rreth aktiviteteve, rezultateve, të hyrave dhe shpenzimeve tuaja për publikun (jo vetëm për donatorët tuaj)?
- A janë dy njerëz në organizatë përgjegjës për rishikimin dhe aprovimin se sa para janë hargjuar?
- A keni bërë auditimin financiar të organizatës cdo vit?
- A takohet bordi juaj cdo tre muaj për të rishikuar dhe aprovuar të hyrat dhe shpenzimet e organizatës tuaj?

Nëse përgjigja është “jo” në ndonjërin prej tyre, ju mund të përmirësoni transparencën dhe menaxhimin financiar të organizatës. Këtu janë disa gjëra që ju mund të bëni dhe duhet t’i bëni. Ato kushtojnë pak ose asgjë dhe mund të ju ndihmojnë që të përmirësoni imazhin e organizatës tuaj dhe kështu imazhin e OJQ-ve dhe shoqërisë civile në përgjithësi:

1. Përgatitni një raport vjetor me informatat rreth aktiviteteve, rezultateve, të hyrave dhe shpenzimeve tuaja. Bëjeni të arritshëm për publikun. Ju mund ta vendosni atë në faqen tuaj në Facebook; bëjeni në faqe jo të shtrenjta, bardhë e zi dhe/ose mund të ofroni informata në konferenca për shtyp. Raportimi vjetor është vendimtar për tu treguar bashkëpunëtorve tuaj, anëtarëve, mediave, donatorëve dhe qytetarëve se si i keni përdorur financat tuaja dhe çfarë rezultatesh keni arritur. (Për një shembull të raportimit vjetor, shikoni uebfaqen e [RrGGK](#)).
2. Sigurohuni që dy persona të ndryshëm rishikojnë dhe aprovojnë shpenzimet financiare. Kjo është e rëndësishme drejt menaxhimit financiar të përgjegjshëm dhe transparent.
3. Sigurohuni që keni një bord aktiv, politika për ndërrimin e bordit (kështu që anëtarët mund të ndërrohen cdo vit në përputhje me udhëzimet e qarta) dhe mbledhjet e rregullta cdo tre muaj me anëtarët e bordit. Gjatë mbledhjeve, anëtarët e bordit mund të rishikojnë dhe aprovojnë aktivitetet dhe financat e organizatës tuaj.
4. Në rast se ju mermi fonde, vecanërisht më shumë se €100,000 për një vit, nënshtrojeni një auditimi vjetor të jashtëm. Raportoni rezultatet tek publiku, administrata tatimore dhe zyra e regjistrimit të OJQ-ve.

Na tregoni edhe neve se pse jeni Feministe!

Postoni fotot & arsyet këtu.



“Unë jam Feministe sepse besoj që pamja ime nuk përcakton vlerat e mia.”

– Donjeta Berisha

rezultatet tek publiku, administrata tatimore dhe zyra e regjistrimit të OJQ-ve. Në propozimin tuaj për buxhetin, kërkoni nga donatori që të financoj auditimin e shpenzimeve të projektit. Shumica e donatorëve do ta bëjnë. Nëse jo, ose nëse keni mungesë të fondeve për auditim, përfshini (jo staf) anëtarë, përfitues dhe bashkëpunëtor që të auditojnë financat tuaja në mënyrë vullnetare. Ata mund të rishikojnë buxhetin tuaj, faturat dhe aktivitetet, duke shkruar një letër me të gjeturat e tyre. Bëjeni letren të arritshme për publikun.

5. Filloni një regjistër, duke regjistruar 1) datën; 2) punën vullnetare, kontributet vetanake dhe donacionet e dhëna organizatës tuaj; dhe 3) nga kush. Bazuar në cmimet e tregut, kalkuloni vlerën e këtyre kontributeve. Atëherë, ju do të jeni në gjendje të tregoni me dëshmi kontributet vetanake që keni marrë.

6. Mermi pjesë në punëtoritë e RrGGK mbi menxhimin financiar. Zakonisht këto trajnime kushtojnë €250-300 për individ, por RrGGK i ofron këto pa pagesë për anëtarët e saj.

Nëse keni pyetje tjera dhe keni nevojë për këshillë, na shkruani në info@womensnetwork.org ose na kontaktoni për të aranzhuar një takim .